



---

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 03.05.2018,  
e cila filloi në orën 10:00.

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP të pavarur, Nol Nushi, GP i pavarur, Drilon Pireva, GP i pavarur, Bashkim Beha, GP i pavarur, Genc Sherifi, GP i pavarur, Mimoza Sylejmani, GP i pavarur, Qëndrim Sahiti, GP i pavarur, Adrian Berisha, GP i pavarur, Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Egzon Azemi (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Valbona Petrovci (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Sokol Havolli (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Milazim Vitija (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Migjen Shala (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Yll Bogaj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sokol Berisha (AAK), Suzan Kika (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Deri (AKR-AA), Bukurie Canolli (LB) dhe Baton Dushi (Nisma).

**Munguan:** Visare Gashi, GP i pavarur, Mirsad Vitia (LVV), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK) dhe Uran Ismaili (PDK).

**Të pranishëm ishin edhe** drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesuesi i Kuvendit.

Para se të fillohet me diskutim për rendin e ditës, kryesuesi i njoftoi të pranishmit për ndryshim dhe plotësim në rendin e ditës, për një kërkesë urgjente nga FSK-ja dhe nga KFOR-i për ndarjen e një hapësire për ngritjen e një obelisku për ushtarët e KFOR-it që kanë vdekur në Kosovë.

**Leutrim Retkoceri** tha se është i mirëpritur propozimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e obeliskut për pjesëtarët e KFOR-i dhe të NATO-së, mirëpo ne e kemi ngritur edhe në seancat paraprake një çështje, sheshin Adem Jashari dhe propozimin për vendosjen e bustit të sheshit Adem Jashari, andaj mos të tregohemi kaq servil krahasuar me vlerat e huaja e ti nënvlerësojmë vlerat tona.

**Eman Rrahmani**, propozoi që në rend dite të jetë edhe propozimi i dy anëtarëve të Kuvendit nga GP i LVV-së në Komitetin për Politikë dhe Financa.

**Halim Halimi**, tha se duke pasur parasysh që LDK-ja është grup parlamentar me numër më të madh në Kuvend, kërkoi që në Komitetin për Politikë dhe Financa të përfaqësohet edhe me një anëtar nga GP i LDK-së.

**Leutrim Retkoceri**, propozoi që pika “Pyetje dhe përgjigje” të jetë pika e tretë në rend dite **Shefki Gashi**, kërkoi që grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvend sipas numrit të anëtarëve që e kanë të radhiten në ulëset e Kuvendit, ashtu si ka qenë praktikë e më hershme. **Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e Egzon Azemit për zëvendësimin e anëtarëve në Komitetin për Politikë dhe Financa.

**Kryesuesi konstatoi se me 24 vota për, 5 kundër dhe 4 abstenime, hynë në rend dite për diskutim propozimin për zëvendësimin e anëtarëve në Komitetin për Politikë dhe Financa.**

**Vala Peshku** tha se nuk pajtohem për propozimin që pika “Pyetje dhe përgjigje” të jetë në fillim të rendit të ditës, dhe mendoj që duhet me mbet si pikë e fundit për arsye se si pikë e parë deri tash ka qenë absolut jo produktive.

**Eman Rrahmani** tha se e përkrahi propozimin që pika “Pyetje dhe përgjigje” me dal si pikë e parë e rendit të ditës.

**Nol Nushi** tha se pika “Pyetje dhe përgjigje” në fakt nuk është që zgjidh ndonjë send përpos që na ofron mundësinë me dal në televizion, se përgjigjen e njëjtë mundemi me e marrë edhe prapa dyerve të këtij Kuvendi.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e Leutrim Retkoceri, që pika “Pyetje dhe përgjigje” të jetë në fillim të rendit të ditës.

**Kryesuesi konstatoi se me 18 vota për 25 kundër dhe 1 abstenim, nuk kalon propozimi i Leutrim Retkoceri që të futet si pikë e tretë e rendin të ditës.**

**Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës dhe konstatoi se me 39 vota për, 2 kundër, me ndryshime dhe plotësime u miratua ky**

### Rend i ditës

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e Obeliskut në përkujtim të pjesëtarëve të KFOR-it dhe të NATO-s;
3. Miratimi i Raportit financiar të tremujorit të parë (TM1) të vitit 2018;
4. Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për transparencë;
5. Propozimvendimi për iniciimin e binjakëzimit të kryeqytetit të Kosovës me kryeqytetin e “Des Moines” IOWA-së;
6. Propozimvendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);

7. Propozimvendimi për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
8. Propozimvendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018;
9. Propozimvendimi për shitjen e pronës së luajtshme të Komunës;
10. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

#### Pika e parë

#### Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Vesel Makolli tha se sot është dashtë që ta kemi ekstraktin e mbledhjes së fundit të Kuvendit. Kërkoj që për mbledhjet e radhës ekstrakti i mbledhjes së fundit të jetë i gatshëm për miratim. Kryesuesi tha se një prej arsyeve që po vonohen ekstraktet është edhe për shkak të mungesës së stafit, në mungesë të një lektor e që një lektorë është për krejt komunën për çdo çështje, prandaj kjo çështje duhet të zgjidhet ndoshta me rritjen e numrit të punëtorëve dhe me proceset tjera.

Kryesuesi konstatoi se me 38 vota për, 2 abstenime, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

#### Pika e dytë

#### Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e Obeliskut në përkujtim të pjesëtarëve të KFOR-it dhe të NATO-s.

Kryesuesi hapi diskutimin.

**Leonora Shabani-Bajraktari**, në emër të GP të LVV-së tha se votimi i këtij propozimvendimi të bëhet më vonë, derisa të informohemi më në detale nga drejtorja përkatëse rreth këtij materiali.

**Genc Bashota**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm në pika të shkurtra i njoftoi të pranishmit rreth vendosjes së Obeliskut në përkujtim të pjesëtarëve të KFOR-it dhe NATO-s.

**Halim Halimi**, në emër të GP të LDK-së tha se edhe ne këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

**Vesel Makolli**, në emër të GP të AKR-AA tha se këtë propozimvendim e përkrahim për miratim. **Migjen Shala** në emër të GP të PDK-së tha se edhe ne jemi për vendosjen e obeliskut, por ka qenë e rrugës që për sheshin "Adem Jashari" ta mbajmë një seancë, të shikojmë çka kemi mundësi të bëjmë në mënyrë ligjore ti rregullojmë këto sende, jo t'ia heqim këtij sheshi emrin "Adem Jashari". Nuk shkon aty monumenti jugosllav i ish sistemit komunist dhe i bashkim-vëllazërimit me shtatoren e Adem Jashari.

**Besnik Mujeci** tha se duke pasur parasysh faktin se edhe sheshi është i ngarkuar jashtëzakonisht shumë me përmendore dhe me obeliskë, mendoj që aty ku është propozuar vendosja e tij, nuk është vendi adekuat që ti caktohet midis sheshit të Prishtinës, një obelisk i tillë.

**Egzon Azemi** tha se jemi pro vendosjes së këtij obelisku por nuk do të ishte mirë që monumentet dhe varrezat e dëshmorëve të UÇK-së, të anashkalohen, nuk po mirëmbahen ashtu si duhet, andaj për këtë çështje ekzekutivi duhet sa më shpejtë të ndërmer hapa konkret

Lidhur me shqetësimet e ngritura nga Migjen Shala dhe Egzon Azemi, **Selim Pacolli**, nënkryetar i Komunës dha sqarime të nevojshme.

**Valbona Ajeti** në emër të GP të AAK-së tha se këtë propozimvndim e përkrahim për miratim. **Nol Nushi** në emër të GP të pavarur tha se edhe ne jemi për miratimin e këtij propozimvendimi por do dëshiroja të dijë se a është fjala për ushtarë që janë vrarë gjatë gjithë misionit që kanë shërbyer në Kosovë, apo për ata ushtarë që kanë vdekur aksidentalisht gjatë shërbimit të tyre.

Lidhur me çështjen e ngritur nga z. Nushi, **Genc Bashota**, drejtor i Dejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm dha sqarime të nevojshme.

**Shefki Gashi** tha se emërtimi i shesheve nuk është bërë nga LDK-ja por ato janë emëruar në bazë të një vendimi komunal. Për sheshin Adem Jashari është bërë plani, është bërë projekti, janë ndarë mjetet, për me e ndërtuar sheshin, me e ndërtuar me garazhe nëntokësore, me u ngrit niveli dhe me u vendos sheshi i Adem Jasharit, por përmendorja e Adem Jasharit nuk e ka vendin të vendoset aty, përderisa qëndron monumenti i kohës së komunizmit.

**Eman Rrahmani** tha se jemi pro kësaj dhe do ta përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimvendimin

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri me 40 vota për, u miratua vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e Obeliskut në përkujtim të pjesëtarëve të KFOR-it dhe të NATO-s.**

**Pika e tretë**

**Miratimi i Raportit financiar të tremujorit të parë (TM1), të vitit 2018.**

**Kryesuesi hapi debatin**

**Agim Gashi** në emër të GP të LDK-së tha se në këtë raport mungojnë disa informacione të cilat do të mund të na mundësonin ta vlerësojmë më mirë se në çfarë trendi dhe në çfarë shkalle të zhvillimit të punëve është qeveria komunale. Megjithatë, Raporti TM1 për vitin 2018, prezanton të hyra më të ulëta dhe një performancë të shpenzimeve të caktuara, që do të thotë se ky është një trend negativ i zhvillimit për tremujorin e parë. Sipas raportit të hyrat për këtë tremujor janë 11.99%, më të ulëta në krahasim me TM1 e vitit 2017. Ne propozojmë që qeveria të merr masa në këtë drejtim, se pse performanca është shumë e ulët, kështu siç është prezantuar ky raport, ne nuk do ta përkrahim.

**Eman Rrahmani**, në emër të GP të LVV-së tha se, krahasuar këtë raport me raportin e vitit paraprak tregon një jo efikasitet të qeverisjes, për shkak që kemi rritje të shpenzimeve dhe kemi të hyra shumë më pak, se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Mendoj që qeverisja seriozisht duhet me i marrë parasysh këto statistika të cilat kanë dal këtu, dhe të merret me to, për shkak që në qoftë se vazhdohet me këtë trend deri në fund të vitit, atëherë besoj që do të kemi një ngecje në qeverisje, pra mendoj që është një performancë shumë e ulët për tremujorin e kaluar.

**Vala Peshku**, në emër të GP të pavarur, tha se ky raport është ndodhi, është numër, nuk ka këtu çka votohet apo mundet me u diskutuar pse diçka ka ndodhur, apo nuk ka ndodhur. Pra, por nuk duhet me e kuptuar këtë raport financiar si diçka që ne mundemi me e ndryshuar, sepse nuk ndryshojnë numrat, kjo është ndodhia deri sot. Në parim e përkrahim këtë raport, andaj dhe duhet me e përgëzuar drejtoreshën që me të vërtetë ka bërë mund për me e hartuar këtë raport.

**Leutrim Retkoceri**, në emër të GP të PDK-së tha se ky raport është i përgatitur më mirë se sa ai paraprak që e kemi marr për tre muajt e fundit të vitit 2017, ndërsa në brendësi të këtij raporti kemi vërejtur se komuna ka shënuar të hyra më të ulëta se sa në tremujorin e vitit paraprak, ky është një shqetësim i joni si GP i PDK-së. Vlen të ceket që në mesin e këtyre të hyrave të ulëta janë edhe në lejet e ndërtimit, apo edhe në inkasimet tjera, që është për shqetësim. Ne si GP i PDK-së e inkurajojmë drejtorinë dhe komunën që të bëjë përpjekje që të inkasoj më shumë të hyra, dhe shpenzimet ti reduktoj. Në parim ky raport do ta ketë përkrahjen tonë.

**Valbona Ajeti**, në emër të GP të AAK-së tha se edhe ne në parim do ta përkrahim këtë raport financiar për tremujorin e parë, me shpresën se herën tjetër do të vjen një raport edhe më i mirë.

**Sami Boroci**, në emër të GP të AKR-AA-së tha se ky raport i pasqyron edhe zhvillimet politike në tremujorin e parë të këtij viti, zhvillimet që kanë ndodhur brenda koalicionit në tre muajt e parë, tash edhe në raport po pasqyrohem me numra, kështu që ndoshta nuk ka qenë një qeverisje efektive, ose çfarë ne kemi mujt me e pasë. Shihet se në këtë raport te hyrat nga legalizimi i lejeve janë zero, prandaj ky proces pse ka stagnuar, dhe pse nuk po vazhdon me u zhvilluar më tutje. Si grup në parim e përkrahim këtë raport financiar dhe shpresojmë që deri në fund të vitit do të përmbushet buxheti i këtij viti, ndonëse trendi është jo i mirë për këtë fillim.

**Fiknete Bejta** tha se sipas këtij raporti financiar të tremujorit të parë të vitit 2018, vërehet një shkallë e ulët e realizimit të të hyrave të planifikuara. Ky ekzekutim i dobët i buxhetit do të rezultoi në të ardhmen në tremujorët e tretë, tremujorët e vitit 2018, me shfrytëzim joefikas të fondeve në dispozicion, si dhe do të reduktoi efektivitetin e planeve të shpenzimeve sipas programit. Ky raport financiar është i përmbledhur në mënyrë të përgjithësuar dhe jo i detajizuar, pra mungojnë shpjegimet për pozicionet buxhetore, andaj dhe nuk do ta votojë.

**Shefki Gashi** tha se nuk ka qenë praktikë përpara që të gjithë suksesin ose mos suksesin ta grumbullojnë në një vend të gjitha drejtoritë. Është dashur me pas raport të posaçëm secila drejtori, sa ka pas buxhet, cilat kanë qenë programet e saj, sa e ka realizuar programin për tre muaj ditë, pra drejtoritë është dashtë me pas dhe me e ditur performancën e tyre, deri ku kanë mbërrë në tremujorin e parë, të dytin, të tretin e në të katërtin. Po ashtu në këtë raport është dashtë me u përmend edhe çështja e ndërmarrjeve publike etj.

**Egzon Azemi** tha se ky raport është shumë më pozitivë se sa raporti i kaluar, kështu që për këtë meriton me e lavdëruar drejtoreshën në këtë rast. Mirëpo çka më ka ra në sy këtu dhe çka e kam vërejtur si shqetësim, është që taksa për shfrytëzimin e sipërfaqes publike ka rënë në mënyrë drastike në të hyrat që i ka sjell komunës. Për këtë çështje kërkoi sqarim, pse ka ndodhur një rritje

kaq e madhe te mallrat dhe shërbimet, dhe pse kanë rënë në mënyrë kaq drastike të hyrat nga shfrytëzimi i sipërfaqeve publike.

**Arbenia Murseli**, lidhur me këtë raport kryesisht u ndërlidh rreth ndarjes së mjeteve për trajtimin e qenve endacak dhe për këtë kërkoi të dijë se cilat janë veprimet konkrete që janë ndërmarr për qentë endacak, cila është kompania që është kontraktuar për trajtimin e tyre dhe cilat janë rezultatet deri më tash.

**Nol Nushi** tha se nëse i referohemi pozicionit të të hyrat vetanake për tremujorin e parë 2018, të gjithë zërat të cilët praktikisht janë kompetencë e Komunës kanë ngritje përveç p.sh shpronësime ku në vitin 2017, kemi pasur 800 mijë euro e këtë vit nuk kemi, ama kjo nuk është kompetencë e Komunës, ndërsa për tatimin në pronën e paluajtshme kjo mvaret prej Komunës, por taksa për certifikata dhe dokumente zyrtare nuk varret prej Komunës, por varret prej kërkesës që ka për ato dokumente. Sa i përket shfrytëzimit të sipërfaqeve të dhëna në shfrytëzim, mendoj se duhet me realizuar më shumë të hyra nëse vazhdojmë me të njëjtat sipërfaqe të dhëna në shfrytëzim.

**Sokol Havolli** tha se ky raport ka ende hapësirë për përmirësime sidomos në pjesën e interpretimit dhe sqarimit të zërave buxhetorë. Sa i përket realizimit të buxhetit e kemi një gjendje relativisht të keqe në qytetin e Prishtinës. Është për keqardhje kur i shohim investimet kapitale me një normë tejet të ulët të realizimit, subvencionet dhe transferet po ashtu me ramje të realizimit.

Por çka është shumë e rëndësishme është se planifikimin e këtij buxheti nuk ka asgjë konkrete e cila kishte me zhvilluar qytetin e Prishtinës Për fat të keq është gjendja e realizimit e të gjitha këtyre projekteve që ka nevojë qyteti i Prishtinës, dhe e kemi po thuajse një situatë të stagnimit të plotë e cila në fakt reflektohet edhe vetë nga aktivitetit i kryetarit çoftë në asamble, çoftë në aktivitetet tjera të tij publike.

**Besnik Mujeci** tha se të hyrat nga kodi 18166 taksa dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve publike, ku këtu duke pasur parasysh se tre mujorët e parë të vitit, zakonisht kushtet atmosferike janë të këqija dhe zakonisht ndodh që të ketë më pak të ardhura nga taksa.

Po ashtu te ardhurat nga mbeturinat në tre mujorët e parë të vitit kanë qenë 600 mijë euro dhe ato të ardhura kanë ardhur nga Kompania Rajonale "Pastrimi", e cila ka vjel të ardhura nga gjashtë komunat e tjera të rajonit të Prishtinës, dhe këto janë të ardhura vetëm nga amvisëritë e jo nga bizneset.

**Mimoza Sylejmani** th ase Ligji për legalizim ka përfunduar në mars të vitit të kaluar dhe është bërë një draft dokument i cili tashmë gjendet edhe në Kuvendin e Kosovës. Po sa të jetë gati dhe të miratohet në Kuvendin e Kosovës atëherë do të fillojmë prapë me legalizimin në komunën e Prishtinës.

Lidhur me vërejte dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha **Vaalbona Makolli**, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave.

**Drilon Pireva** tha se sa i përket bartjes së mjeteve në pozicionin buxhetor që ka ë bëjë me suficit ceket se të hyrat vetanake të pa shpenzuara nga viti i mëhershëm në shumën prej 13 milion, janë për bartje në vitin vijues 2018. Këto mjete na paraqiten si suficit buxhetor por janë obligime të kontraktuara d.m.th janë punë që janë duke u realizuar edhe kanë me u bërë pagesat këtë vit, kështu që edhe kjo bartje është e sqaruar në raport.

## **Kryesuesi e hodhi në votim raportin financiar**

**Kryesuesi konstatoi se me 20 vota për, 16 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Raporti financiar i tremujorit të parë (TM1) të vitit 2018.**

### **Pika e katërt`**

#### **Propozim vendimi për miratimin e Planit të veprimit për transparencë**

#### **Kryesuesi hapi diskutimin**

**Muhedin Nushi**, drejtor i Drejtorisë së Administratës, në pika të shkurtra i njoftoi të pranishmit për Planin e veprimit për transparencë.

**Halim Halimi**, në emër të GP të LDK-së tha se këtë plan e përkrahim për miratim.

**Leonora Shabani-Bajraktari**, në emër të GP të LVV-së tha se miratimi i Planit të veprimit për transparencë është jashtëzakonisht i mirëpritur nga LVV-ja, dhe e përkrahim për miratim.

**Vala Peshku**, në emër të GP të pavarur tha se edhe ne këtë plan e përkrahim për miratim.

**Leutrim Rretkoceri**, në emër të GP të PDK-së tha se edhe ne këtë plan e përkrahim për miratim.

**Valbona Ajeti**, në emër të GP të AAK-së tha se edhe ne këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

**Arbenita Murseli**, në emër të GP të AKR-AA, tha se do të ishte shumë me vend nëse ky Plan i transparencës do të zbatohet me përpikëri pa u anashkaluar asgjë.

Janë disa nga pikat në këtë plan të cilat nuk zbatohen në praktik, si p.sh. përgatitja e informatave të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, që duhet të përgatitet një shkresë apo komunikatë zyrtare që të ju dërgohet mediave si dhe të publikohet në faqen zyrtare të Komunës dhe në faqet tjera sociale dhe kjo nuk po ndodhë. Po ashtu vërejtje edhe për veb-faqen e komunës, ku disa emra të anëtarëve të komiteteve kanë mbetur nga mandati i kaluar etj. Kërkoj që për hir të transparencës këto mangësi të shndërrohen në përparësi duke i ofruar qytetarit qasje sa më të lehtë për informim të saktë në lidhje me atë se çka zhvillohet në aktivitetet e Komunës.

**Adrian Berisha** tha se duhet përshëndetur drejtorin e administratës për punën që ka bërë rreth hartimit të këtij plani të transparencës. Por kisha sugjeruar që me u krijuar një plan strategjik për faqet e komunës, ku qytetarët do të kishin një qasje më të madhe në veb-faqen e komunës, për me i kuptuar punët që po i kryen Komuna e Prishtinës.

Për vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, **Muhedin Nushi**, drejtor i Drejtorisë së Administratës dha sqarime të nevojshme.

**Kryesuesi e hodhi në votim planin.**

**Kryesuesi konstatoi se me 40 vota për, 1 abstenim, u miratua vendimi për miratimin e Planit të veprimit për transparencë për vitin 2018.**

## **Pika e pestë**

**Propozimvendimi për inicimin e binjakëzimit të kryeqytetit të Kosovës me kryeqytetin e “Des Moines” IOWA-së**

Kryesuesi hapi diskutimin

**Halim Halimi**, në emër të GP të LDK-së tha se këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

**Vala Peshku**, në emër të GP të pavarur dhe se këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

**Leonora Shabani- Bajraktari**, në emër të GP të LVV-së tha se edhe ne e përkrahim iniciativën për binjakëzimin me shtetet tjera.

**Leutrim Rretkoceri**, në emër të GP të PDK-së tha se edhe ne e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

**Valbona Ajeti**, në emër të GP të AAK-së tha se e përkrahim binjakëzimin me shtetin e IOWA-së.

**Vesel Makolli**, në emër të GP të AKR – AA, tha se e përkrahim për miratim këtë propozimvendim.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri me 41 vota për, u miratua vendimi për inicimin e binjakëzimit të kryeqytetit të Kosovës me kryeqytetin e “Des Moines” IOWA-së**

## **Pika e gjashtë**

**Propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)**

Kryesuesi hapi diskutimin

**Halim Halimi**, në emër të GP të LDK-së tha se e përkrahim për miratim këtë propozimvndim.

**Leonora Shabani- Bajraktari**, në emër të GP të LVV-së tha se e përkrahim themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

**Rifat Deri**, në emër të GP të AKR-AA, tha se edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozimvendim për miratim, por kërkoi që të përmirësohet një gabim, në vend të fjalës “kishë hebreje” duhet të jetë “sinagogë”.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin

**Kryesuesi konstatoi se me 43 vota për, 1 abstenim, u miratua vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**

## **Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës**

Lidhur me Propozimvendimin për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, të gjitha grupet parlamentare të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend i dhanë propozimet e tyre për anëtarë në komitetet e tjera të Kuvendit të Komunës siç janë:



1. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
2. Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;
3. Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Rural;
4. Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit;
5. Komiteti për Shërbime Publike dhe
6. Komiteti për Pronë.

**Me propozimet e dhëna, Kryesuesi konstatoi se njëzëri, me 39 vota për, u miratua vendimi për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.**

#### **Pika e tetë**

**Propozim vendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018**

**Kryesuesi hapi diskutimin**

**Halim Halimi**, në emër të GP të LDK-së tha se jemi për miratimin e këtij plani, por kërkoi që të fshihet pika nr. 3 të muajit shtator, *Informatë mbi fillimin e vitit shkollor 2018/2019*, pasi që e njëjta qëndron në pikën nr.1 po të këtij muaji.

**Vala Peshku**, në emër të GP të pavarur tha se pajtohem me propozimin e z. Halimi, si dhe jemi për miratimin e këtij plani.

**Arbenita Murseli**, në emër të GP të AKR-AA, propozoi që në muajin korrik të mbahen dy seanca e që njëra të llogaritet e muajit gusht.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, me 41 vota për, u miratua vendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018.**

#### **Pika e nëntë**

**Propozimvendimi për shitjen e pronës së luajtshme të Komunës**

**Halim Halimi**, në emër të GP të LDK-së tha se jemi për miratimin e këtij propozimvendimi.

**Muhedin Nushi**, drejtor i Drejtorisë së Administratës tha se mjetet të cilat do ti inkasojmë nga shitja e automjeteve, do ti destinojmë për qëllime të mirëqenies sociale.

**Leonora Shabani- Bajraktari**, në emër të GP të LVV-së tha se e përkrahim për miratim këtë propozimvendim.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, me 40 vota për, u miratua vendimi për shitjen e pronës së luajtshme të Komunës.**

#### **Pika e dhjetë**

**Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa**

**Leonora Shabani- Bajraktari**, në emër të GP të LVV-së, për anëtarë të komitetit propozoi Eman Rrahmanin dhe Egzon Azemin.

**Me propozimin e dhënë, Kryesuesi konstatoi se me 31 vota për, 1 kundër dhe 6 abstenime u miratua vendimi ndryshimin dhe plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa**

**Pika e njëmbëdhjetë  
Pyetje dhe përgjigje**

**Kushtrim Sopa, për nënkryetarin e Komunës, drejtorin e Drejtorisë së Kulturës, drejtorin e Drejtorisë së Administratës, drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, dhe drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave**

-Një grup i të rinjve ka dorëzuar një kërkesë për një kompleks sportiv në hapësirën e lagjes "Arbëria" ish "Cigllana", ata po thirren në investimin nga UNDP-ia dhe Qeveria japoneze një investim 52 milion. Mua mu duk shumë atraktivë ky investim dhe pse mos me e marr e me shqyrtuar Kuvendi komunal. Ajo kërkesë paska ardhur në Komunën e Prishtinës nënkryetari qenka i informuar z. Selim Pacolli, edhe kisha pasur dëshirë me e pru si rend të ditës në Kuvendin komunal.

- Qytetarët e lagjes "Arbëria" kanë filluar një peticion në secilën shtëpi për Qendrën e Mjekësisë Familjare për të shërbyer në shtatë ditë 24 orë, nuk po e di formën se ku duhet me e përcjell peticionin a duhet në drejtori apo vetëm me e sjell në Komunë si kërkesë.

- Propozimi tjetër është se një grup i intelektualëve të cilët për emërimin e shkollës fillore në lagjen "Arbëria" ata po e propozojnë z. Mehmet Gjevorin, hartues i parë i Abetares në Kosovë, mësues nga Elbasani.

- Kërkesë tjetër është kanalizimi te shkolla fillore "Elena Gjika" ose më konkretisht rruga "Ernest Koliqi", aty i ekspozohen fëmijët e shkollës çdo ditë atij kanalizimi dhe ujërave të zeza, që sigurisht është edhe rreziku nga epidemitë e ndrysmë të përhapen. Ky kanalizim është më shumë se gjashtë muaj aty.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Sopa, sqarime të nevojshme dhanë: **Muhedin Nushi**, drejtor i Drejtorisë së Administratës, **Arben Vitia**, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, **Jonuz Salihaj**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe **Gëzim Mehmeti**, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.

**Sheqet Osmani., për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit**

Banorët e lagjes pranë shkollës "Asim Vokshi", janë të shqetësuar me veprimin që ka bërë drejtoresha e shkollës, e cila pa asnjë vendim, pa asnjë miratim ka prerë drunjtë bliri njëzet vjeçar të cilët kanë qenë prapa shkollës. Ata drunjtë i kanë mbjellë qytetarët të cilët jetojnë pranë shkollës.

**Jonuz Salihaj**, drejtor i drejtorisë së Arsimit dha sqarime të nevojshme

**Agim Gashi, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit, për drejtorin e Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe për Kryetarin e Komunës**

- Cilat masa po i merr administrata e komunës për pengimin e hedhjes së mbeturinave nga konstrukcioni dhe demolimi në të gjitha pjesët e Komunës së Prishtinës, pasi që siç e keni pa ju Fusha e Pajtimit ka filluar me u mbushur me mbeturina, kodrat e Hajvalisë gjithashtu pjesa e Matit lartë në mal, gryka e Gollakut atje Mramori, Grashtica, Stallovë etj. Ne e dimë zgjidhjen cila është, por tash nuk është tema për me e hapë.
- Pse inspektorati nuk po pengon ndërtimet pa leje, pasi 5 vjet është bërë zhurmë shumë e madhe për një gjë të tillë, kur plotë objekte në Komunën e Prishtinës në këtë periudhë dhe sot janë ndërtuar pa leje.
- Po ashtu nuk po pengohet shfrytëzimi i hapësirave publike nga shërbimet e ndryshme afariste, dhe atë pa leje.
- Kur do të vijnë 20 autobus të rinj që janë blerë nga Komuna e Prishtinës, dhe çfarë po ndodhë me ta?

**Gëzim Mehmeti** drejtor i Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhimin e Kontratave dha sqarime të nevojshme

**Sami Boroci, për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit, drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Kryetarin e Komunës**

- Në lagjen “Dardania” i kam marrë disa kërkesa për një ambient që sipas banorëve aty, është shumë i papastër. Para disa ditëve nga komuna janë marrë disa iniciativa ose aktivitete që janë tentuar me u pastruar këto lagje, mirëpo ambienti vazhdon me mbet i papastër. Po ashtu në pjesën e Veterrnikut, ose konkretisht te Fshati ndërkombëtar dhe ajo pjesa që shkon te Pallati i Drejtësisë, sidomos rreth rrugës që shkon edhe deri te banesat sociale në Hajvali. Kisha kërkuar prej drejtorisë përkatëse, që këtë problem me e trajtuar dhe me u munduar sa më shpejt me i pastruar këto pjesë.  
Ka disa kërkesa të individëve të udhëkryqi te Farmedi, që me e bërë një zgjidhje, ose semafor ose rreth rrotullim, nuk po e di a ka komuna hapësirë me bërë diçka të tillë.
- Kur ka me u krijuar Drejtoria e Parqeve, këtë kërkesë e kemi parashtruar edhe në seancën
- e kaluar, pra është kërkesë e GP të AKR-AA.

**Adrian Berisha, për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit dhe drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike**

- Bizneset e ndryshme në qytet, siç janë disa p.sh. “Sarajeva” në Bregun e Diellit te rruga “B” e qetë tymin e oxhakut midis banesave dhe asnjë banorë nuk po mundet më me jetuar qysh duhet, nga era që del nga oxhaku. Po ashtu edhe në lagjen “Dardania” i njëjti shqetësim i qytetarëve është edhe për biznesin që ushtrohet te “Bosna”.
- Po ashtu shqetësuese janë edhe shportat e vogla për hudhjen e mbeturinave në veçanti në rrugën “Luan Haradinaj” dhe kërkoi që ato shporta të jenë më të mëdhaja.

- Shqetësues janë edhe hudhja e fletushkave nga korporatat e ndryshme që bëjnë biznese siç janë “Interexi”, “Minimaxi”, “Meridiani”, krejt këto i gjuajnë fletushkat aty duke e ndotur ambienti për rreth. Kërkoj që në këtë drejtim të merret ndonjë masë parandaluese.
- Gjithashtu kërkoj nga drejtoria përkatës që sheshi i qytetit të mos pengohet me karrika dhe tavolina të bizneseve të ndryshme, por të jetë i lirë për lëvizje të qytetarëve, pra të shikohet mundësia e gjetjes së ndonjë formule që sheshi i qytetit me kanë sheshi i qytetarëve, ku ka rregull, rend, harmoni, sepse është i vetmi atraksion përveç të “Albit mall” që na mundemi me kaluar.

**Egzon Azemi, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit dhe Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm**

- Kur do të fillojnë punën në rregullimin e varrezave të dëshmorëve në fshatin Marec, pyetje të cilën e kamë parashtruar edhe në mbledhjen e fundit të Kuvendit.
- Në lagjen Dardania, nën “Kurriz” disa vendkalime ku lidhen me shkollë, dhe aty kalojnë fëmijët, ka rrjedhje të kanalizimit prej lokaleve që janë lartë, dhe është një problem shumë i madh ky. Kështu që besoj që është mirë me intervenuar sa më parë inspektorati apo kushdo që është përgjegjës për këtë çështje.
- Në rrugën “Hysni Curri” në pjesën afër “Teatrit të Babës”, ka kërkesa nga qytetarët me e dit se a është gati Plani rregullues, në çfarë gjendje është, për shkak se që një kohë të gjatë, kanë mbetur pa informacione lidhur me këtë çështje.

**Gëzim Mehmeti**, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave për pyetjet e parashtruar rreth ndërtimit të varrezave të dëshmorëve në fshatin Marec, dha sqarime të nevojshme.

**Arbenita Murseli, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave**

Në seancën e tretë të regullt ju kam parashtruar një kërkesë të marrë nga qytetarët e fshatit “Ballaban të epërm” më konkretisht është fjala për rrugën totalisht të degraduar të fshatit Ballaban të epërm e që vazhdon deri tek fshati Nishevc. Sipas qytetarëve kjo rrugë referohet si rruga prej Kujevit deri tek shtëpia e ish shtabit të UÇK-së. Qarkullimi i qytetarëve në atë rrugë po vështirësohet çdo ditë e më shumë. Po e riparashtrorj këtë kërkesë edhe një herë sepse një banor i kësaj zone është shumë i interseruar të hapë një fermë të lopëve në këtë fshat, ndërsa mungesa e infrastrukturës po ja pamundëson këtë gjë. Andaj si drejtor ju kërkoj që kjo rrugë të jetë në fokusin kryesor që të shtrohet ne asfalt, ku do t’iu lehtësonte jetën shumë qytetarëve, ndër ta edhe ndërmarrës që do ti shfrytëzojnë edhe resurset e pazëvendësueshme natyrore që i ka Prishtina.

**Rifat Deri, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për drejtorin e Drejtorisë së Kulturës, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për Drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit, dhe për Kryetarin e Komunës**

- Kur do të filloi shtrimi i rrugës deri te kalaja e Keqekollës;
- Kur do të bëhet definimi i zonës historike të Prishtinës.
- Në mbledhjen e kaluar kam ngritur shqetësimin e madh të qytetarëve të Prishtinës në lidhje me emërtimin e rrugëve dhe institucioneve të kryeqytetit. Por meqë, nuk kam marrë asnjë përgjigje, po e parashtroj këtë çështje përsëri, me shpresë se këtë herë do të marrë ndonjë përgjigje.

a. A është ende funksional komisioni për emërtimin e rrugëve dhe insitucioneve?

b. Kush janë, apo kush kanë qenë anëtarë të këtij komisioni?

c. Si është bërë përzgjedhja e tyre? Pra, cilat ishin kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit, sepse mendoj që punën e kanë bërë shkel e shko.

Po ju jap vetëm disa emërtime që për qytetarët, e besa edhe për mua, janë qesharake dhe ofenduese:

Maja e drites, Demir Demiraj, Jakup Cerraja, Marin Biqikemi, Qorr Ilazi, (një ofendim ky dhe për z.Ilazin por edhe për Prishtinasit); rruga Washington – për kend bëhet fjalë këtu? Për Washingtonin si kryeqytet, për Washingtonin si shtet apo për Washingtonin si president? Rr. Shëndeti, etj etj.

Nuk e pashë në listën e publikuar as emrin e artistes së merituar Melihate Ajeti, e as emrat e shumë e shumë njerëzve tjerë meritore për kryeqytetin.

1. Shqetësim tjetër që qytetarët e kanë ngitur gjatë bisedave me mua është edhe ai që ndërlidhet me kamionët që bartin beton nëpër rrugët e Prishtinës. Gjatë bartjes shumica e këtyre kamionëve e derdhnin një pjesë të betonit nëpër rrugë, ndërkohë që as vozitësit e papërgjegjshëm e as kompanitë që e bëjnë këtë gjë nuk ndëshkohen. Ky beton përveq që e vështirëson qarkullimin e automjeteve, ka raste kur edhe i dëmton ato, megjithëse edhe i shëmton vetë rrugët e kryeqytetit.

Unë gjatë fushatës parazgjedhore kam propozuar që në kuadër të të drejtorisë së urbanizmit të kemi edhe inspektionin që do të merrej vetëm me lëminë e ndotjes së ambientit, qoftë me mbeturina inerte apo me lloje të tjera mbeturinash. Ky inspektion do t'ia lehtësonte punën edhe Drejtorisë së Inspektionit, i cili edhe ashtu është tejet i ngarkuar me punë.

2. Në mbledhjen e kaluar e kam parashtuar pyetjen që ka të bëjë me fillimin e funksionimit të kompanisë Prishtina Parking, por nuk mora përgjigje se kur kjo kompani komunale do të filloj me punë.
3. Shënjimi i korsive të rrugëve dhe vendkalimeve për këmbësorë në qytet. A mundemi me pasë informatën se sa kanë garancion nga kompania punëkryese shënjimet që iu bëhen rrugëve të Prishtinës? E kam fjalën këtu për afatin e qëndrueshmërisë së ngjyrës.

Kjo për shkak se qyteti, përveç që është më i sigurt kur shënjimi është në vendin e duhur, edhe duket më bukur.

Dhe pyetja tjetër: Kur do të fillohet me shënjimin e rrugëve sivjet?

*Mbledhja përfundoi në orën 13:15.*

**Procesmbajtësi**  
**Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Agim Kuleta**